



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E ARSIMIT  
 SPORTIT DHE RINISË**  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

**PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2019**

**I DETYRUAR**

**Lënda: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi**

**Model Testi**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

<b>Kërkesa</b>									
<b>Pikët</b>									
<b>Kërkesa</b>									
<b>Pikët</b>									
<b>Kërkesa</b>									
<b>Pikët</b>									

Totali i pikëve

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1..... Anëtar/e

2..... Anëtar/e

## PJESA I

## GJUHË SHQIPE

## A janë të ndryshëm?

Djemtë janë më të mirë në matematikë dhe në shkencat natyrore; vajzat janë më të mira në gjuhë. Burrat janë më konkurrues; gratë janë më të edukuara. A janë të sakta këto pohime, apo janë stereotipa gjinorë që kufizojnë potencialin e vërtetë të një personi?

Duke u mbështetur në zhvillimet e teknologjisë, që bën të mundur krijimin e imazheve të trurit, shkencëtarët tani janë në gjendje t'i përqendrojnë studimet e tyre në disa zona specifike të tij. Për ta nisur që nga fillimi, truri i meshkujve është rreth dhjetë përqind më i madh se ai i femrave. Edhe kur ky krahasim është në përshtatje me peshën trupore, truri i meshkujve është sërish më i madh. Kjo mund të çojë në supozimin se meshkujt janë më inteligjentë. Megjithatë, testet e inteligjencës, në një pjesë të madhe, kanë treguar se burrat dhe gratë kanë arritje të njëjta në të gjitha fushat.

Nga ana tjetër, truri i femrave ka një sipërfaqe më të madhe të *corpus collosum*. Ky rrjet i nervave është përgjegjës për të lidhur të dy anët e trurit. Kjo lejon që pjesa e djathtë, më emocionale, "t'i flasë" pjesës së majtë, më analitike të trurit. Dikush mund të mendojë se gratë janë më inteligjente, po as kjo nuk është e vërtetë. Teknologjia ka treguar se truri i meshkujve është më i specializuar dhe përdor pjesë specifike për të realizuar detyrat.

Në zhvillimin e trurit, gjithashtu, një rol luan dhe shkalla e pjekurisë. Madhësia e trurit të femrave arrin kulmin rreth moshës njëmbëdhjetë e gjysmë; madhësia e trurit të meshkujve zakonisht e arrin këtë kulm tri vite më vonë. Si pasojë, vajzat janë më në gjendje të komunikojnë verbalisht, demonstrojnë aftësi në të shkruar dhe për të mbajtur mend fytirat e njohura në një moshë më të hershme se djemtë. Megjithatë, zona të caktuara në tru, që merren me arsyetimet mekanike dhe në hapësirë, maturohen më shpejt te djemtë. Kjo i bën ata më të aftë në përpunimin e objekteve 3-D.

Duke u bazuar në këto gjetje, do të dukej e natyrshme të arrinin në përfundimin se meshkujt duhet të ndjekin karrierat në fushat e matematikës dhe të shkencave të natyrës dhe femrat duhet të përfshihen në ato punë që kërkojnë aftësi sociale dhe gjuhësore. Por ky përfundim do ishte i gabuar. Përgjatë kërkimeve që kanë bërë, shkencëtarët kanë zbuluar se truri i njeriut ka shumë dhunti. Ai përgjigjet në mënyrë të favorshme ndaj çdo nxitjeje dhe pritshmërive të mëdha. Në vitet 1800 fushat e fizikës, astronomisë, kimisë dhe botanikës konsideroheshin lëndë për vajzat dhe ato i tejkalonin djemtë në këto lëndë. Në atë kohë, djemtë studionin gjuhë të huaja si latinisht dhe greqisht, lëndë të cilat sot konsiderohen si pika më e fortë e femrave. Edhe në ditët tona, në shumë shtete, vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë në matematikë dhe në fizikë.

Debati vazhdon dhe sërish bëhen pyetje. A janë për shkak të natyrës biologjike disa sjellje të caktuara te njerëzit, apo njerëzit sillen si pasojë e edukimit që kanë marrë? Cili nga të dy sekset është më inteligjent? Pavarësisht zbulimeve të fundit që janë bërë në lidhje me trurin e njeriut, këto pyetje, padyshim, do të mbeten pa përgjigje për shumë kohë.

1. Cila nga karakteristikat e mëposhtme e orienton këtë tekst drejt llojit argumentues? 1 pikë
  - A) Argumentimi mbështetet me shprehje të figurshme.
  - B) Gjuha e këtij teksti është përshkruese.
  - C) Informacioni në tekst mbështetet me fakte.
  - D) Teksti ka një temë qendrore.
  
2. Cila nga alternativat e mëposhtme përbën tezën që mbështet autori, në këtë fragment? 1 pikë
  - A) Duke qenë se madhësia e trurit të femrave e arrin më shpejt kulmin në raport me madhësinë e trurit të meshkujve, ato janë më inteligjente sesa meshkujt.
  - B) Meshkujt, për shkak të përqindjes më të lartë të trurit në raport me femrat, janë më inteligjentë se ato.
  - C) Vajzat janë të prirura më shumë drejt lëndëve shoqërore, ndërsa djemtë drejt atyre natyrore.
  - D) Truri i meshkujve dhe femrave funksionon në mënyrë të ndryshme.

3. Në paragrafin e katërt autori paraqet disa të dhëna për të sugjeruar se: **1 pikë**
- A) femrat janë më të zonjat t'i shprehin me fjalë mendimet e tyre në një moshë më të hershme se meshkujt;
  - B) femrat në adoleshencë e shprehin veten më mirë me gojë sesa me shkrim;
  - C) meshkujt janë përgjithësisht më të mirë se femrat, kur flasin në publik;
  - D) meshkujt ka mundësi të shquhen më shumë se femrat në shkencat sociale.

4.

- a) Në ç'mënyrë e mbështet autori pikëpamjen e tij në paragrafin e katërt? **1 pikë**

---

---

- b) E ç'lloji është, nga pikëpamja e ndërtimit, fjalia: *Për ta nisur që nga fillimi, truri i meshkujve është rreth dhjetë përqind më i madh se ai i femrave?* **1 pikë**

---

5.

- a) Në fjalinë: *Kjo lejon që pjesa e djathtë më emocionale "t'i flasë" pjesës së majtë më analitike të trurit, cili është mjeti që shërben si burim morfologjik i shprehësisë (mjet gjuhësor që ndikon në figurshmërinë e frazës)* **1 pikë**

---

- b) Shkruani bërthamën e paragrafit të dytë. **1 pikë**

---

6. Pse autori në paragrafin e pestë krahason qëndrimet historike me ato moderne kundrejt vajzave dhe djemve? **1 pikë**

---

7.

- a) Identifikoni dy karakteristika gjuhësore, tipike për këtë lloj teksti. **2 pikë**

---

---

- b) Zbuloni në paragrafin e dytë një formë të pashtjelluar foljore. Shkruajeni fjalinë, duke e kthyer formën e pashtjelluar foljore në folje, pa prishur kuptimin e fjalisë. **2 pikë**

---

---

- c) Identifikoni dy tipare që e bëjnë të veçantë mbylljen e këtij teksti, duke u mbështetur në llojin e tij. **2 pikë**

---

---

8. Formuloni pyetjen së cilës kërkon t'i japë përgjigje autori. Cila mund të jetë një nga arsyet që ai e kërkon këtë përgjigje? 2 pikë

Pyetja: \_\_\_\_\_

Arsyeja: \_\_\_\_\_

### Dervishi dhe vdekja (fragment)

[1] Hapësira është burgu jonë. [2] Këtë e thashë duke u përqendruar në jehonën e mendimeve të mija të panjohura, duke qenë përshtatur në një zjarr të ri dhe të papritur, në bisedën e vdekur dhe të panevojshme deri në atë çast. Hapësira na zotëron plotësisht. Ne e zotërojmë për aq sa syri ynë mund të pushtojë. [3] Dhe, ajo ne na lodh, na shqetëson, na zhvesh. [4] Ne mendojmë që ajo na shikon dhe aq i bën për ne, por dua të them se ne e kemi zotëruar atë dhe vetëm e shfrytëzojmë çpërqendrimin e saj. Neve nuk na është dhuruar toka. [5] S'dimë sepse ndodh kështu. Vetëtimat dhe dallgët e ndriçuara nuk janë për ne, ne jemi për ta. [6] Njeriu nuk ka shtëpinë e tij të vërtetë, ai e pushton atë prej forcave të verbëta. [7] Kjo është një strehë e huaj toka mund të ishte vetëm si vendbanim i përbindshave, që do të ishin në gjendje të luftonin me fatin e zi, që ajo e ka aq të plotë e me bollëk. [8] Nuk e pushtojmë tokën, por vetëm një copëz, thjeshtë atë që duhet për shputat tona, as malin, vetëm pamjen në syrin tonë dhe as detin, por vetëm forcën e tij lëvizëse dhe \_\_\_\_\_ e sipërfaqes së tij.

9. Si duhet ndryshuar fjalia [1]? 1 pikë

- A) Të ndryshohet *hapësira* me *hapsira*.
- B) Të ndryshohet *jonë* me *ynë*.
- C) Të fshihet folja *është*.
- D) Të lihet fjalia siç është.

10. Çfarë ndryshimi është i nevojshëm në fjalinë [2]? 1 pikë

- A) Të fshihet presja pas fjalës *të panjohura*.
- B) Të ndryshohet *të mija* me *të mia*.
- C) Të ndryshohet *të panevojshme* me *të panevojëshme*.
- D) Të zëvendësohet mbiemri *e vdekur* me *e pajetë*.

11. Si duhet rishkruar fjalia [3]? 1 pikë

- A) Dhe ajo neve na lodh, na shqetëson, na zhvesh.
- B) Dhe, ajo neve na lodh, na shqetëson, na zhvesh.
- C) Dhe ajo ne na lodh, na shqetëson na zhvesh.
- D) Të lihet fjalia siç është.

12. Çfarë ndryshimi duhet bërë në fjalinë [4]? 1 pikë

- A) Të ndryshohet *çpërqendrimin* me *shpërqendrimin*.
- B) Të ndryshohet *e kemi zotëruar* me *e zotërojmë*.
- C) Të hiqet presja pas *ne mendojmë*.
- D) Të lihet fjalia siç është.

13. Çfarë ndryshimi duhet bërë në fjalinë [5]? 1 pikë
- A) Të ndryshohet **sepse** me **pse**.  
B) Të ndryshohet **kështu** me **ashtu**.  
C) Të ndryshohet **s'dimë** me **se dimë**.  
D) Të lihet fjalia siç është.
14. Çfarë ndryshimesh duhen bërë në fjalinë [6]? 1 pikë
- A) Të vendoset lidhëza **dhe** pas presjes.  
B) Të hiqet presja.  
C) Të ndryshohet **të verbëta** me **të verbra**.  
D) Të lihet fjalia siç është.
15. Çfarë ndryshimi duhet bërë në fjalinë [7]? 1 pikë
- A) Të vendoset presje pas **e huaj**.  
B) Të ndryshohet **të plotë** me **të plot**.  
C) Të ndryshohet **ajo** me **ai**.  
D) Të ndryshohet **përbindëshave** me **përbindshave**.
16. Çfarë ndryshimi duhet bërë në fjalinë [8]? 1 pikë
- A) Të hiqet presja pas **as malin**.  
B) Të ndryshohet **thjeshtë** me **thjesht**.  
C) Të ndryshohet **atë** me **asaj**.  
D) Të ndryshohet **copëz** me **copë**.
17. Cila nga fjalët e mëposhtme duhet vendosur në vendin bosh në fjalinë [8]? 1 pikë
- A) Pamjen.  
B) Ashpërsinë.  
C) Ndjesinë.  
D) Përmasa.
18. Ku do të ishte vendi më i përshtatshëm për ta shtuar fjalinë e mëposhtme?  
*Asgjë nuk është jona, veç hamendësimit, ndaj ne mbahemi aq fort në të.* 1 pikë
- A) Pas fjalisë [2].  
B) Pas fjalisë [5].  
C) Pas fjalisë [7].  
D) Pas fjalisë [8].

## PJESA II

## LETËRSI

## Poradeci

## Kur në flakë

Kur në flakë të qiririt ze mendohem net-për-net  
Dh'e ndej shpirtin e kulluar nëpër dritën që më tret  
Prej skëterrës së pa matë më del bot' e ëndërruar,  
Vetëm ti, o im-e dashur net-për-net më ri larguar.

Po çdo ëndërr që më çfaqet prej skëterrës së pafund,  
Çdo mendim i llaftaruar që më dhemb e më përtund,  
Dyke rënë prej së lartash posi pikë zembërate  
T'i përshkohet për-së-felli bukuris' së qenies sate.

T'i përshkohet mes-për-mezi dlirtësis' së shpirtit tënd,  
Ta merr pamjen e fytyrës, bëhet shkronjëz e kuvënd.  
Ay del prej shkretëtire mënt' e mi të m'i stolisë  
E ka tingëll llaftarie, ka verbimin e magjisë,  
Ndrin i kthiellt e i pastër si pasqyrëz' e një kroj  
E nër të fytyrën t'ënde t'a vështroj...nuk t'a vështroj...

O! fytyr' e vjershëruar që më mbush me dëshërimë!  
Q'i fal gas përjetësie dashuris' së zemrës s'ime!  
Që më bën kur mënt' e mija regëtinë varg e varg  
Të të ndej aq fare pranë, të më jesh aq shumë larg.

19. Gjendja shpirtërore e unit lirik në vargjet e mësipërme shpaloset përmes kontrastit: **1 pikë**

- A) dashuri/vuajtje;
- B) fitore/humbje;
- C) optimizëm/pesimizëm;
- D) trishtim/ngushëllim.

20. Në vargun: *Po çdo ëndërr që më çfaqet prej skëterrës së pafund*, simboli i **skëterrës** lidhet me: **1 pikë**

- A) errësirën e natës si proces natyror;
- B) errësirën e pushtimit të zemrës nga dashuria;
- C) ngjyrën e errët të kujtimeve të trishta;
- D) thelbin e natyrës njerëzore (pavetëdijen).

21. Sipas poetit rruga e bashkimit të shpirtave të kulluar e të dëlirë sigurohet përmes: **1 pikë**

- A) ëndrës (si gjendje që i paraprin realitetit);
- B) fjalës së poezisë (si model i procesit krijues);
- C) magjisë (si fenomen i mbinatyreshëm);
- D) perëndisë (si krijuese e universit).

22. Cilat janë shqisat që ngacmohen më së shumti në këtë poezi? 1 pikë

---

---

23. Si e perceptoni portretin e femrës, të sjellë nga Lasgushi në poezinë e mësipërme? 1 pikë

---

24.  
a) Zbërtheni nëntekstin që mbart titulli i poezisë. 2 pikë

---

---

b) Kandili është marrë nga folklori si shprehje e *simbolikës së jetës*. Cili është kuptimi *origjinal* që i jep Lasgushi këtij simboli në poezi? 1 pikë

---

---

25. Zbuloni detajin që autori e merr nga natyra, për të krijuar një imazh të caktuar në këtë poezi. Cila është figura stilistike e krijuar? Interpretoni imazhet që ju zgjohen nga ky përdorim. 3 pikë

Detaji: \_\_\_\_\_

Figura: \_\_\_\_\_

Interpretimi: \_\_\_\_\_

---

26. Identifikoni një veçori të formës së lirikës së Poradecit, duke ilustruar me vargje nga poezia. 2 pikë

---

---

## Hygo

## Katedralja e Parisit (fragment)

Turma u sul te kisha dhe nxori së andejmi plot bujë papën e nderuar të gaztorëve. Por vetëm atëherë mahnitja dhe admirimi i popullit arritën kulmin; ngërdheshja ishte fytyra e tij e vërtetë ose, më mirë të themi, e tërë pamja e tij ishte një ngërdheshje. Një alamet koke, e mbuluar me flokë të kuqërremtë e të kreshpëruar; një gungë e madhe midis dy supeve dhe një gungë tjetër, si kundrapeshë e së parës në kraharor; ca kofshë dhe shalë aq të shtrembra, saqë mund të çikeshin vetëm te gjunjët, dhe që, po t'i shihje nga përpara, ngjanin si dy drapërinj të bashkuar te doreza, shputa të gjera këmbësh, duar të përbindshme. Por, megjithë këtë shëmtim, tërë figura e tij shprehte një forcë, zhdërvjelltësi dhe guxim të hatashëm,- përjashtim i çuditshëm nga ajo rregull e përgjithshme, sipas së cilës forca, sikundër bukuria, duhet të burojë nga harmonia.

Kur u duk ky lloj ciklopi te pragu i kishëzës, i palëvizur, me trup shulak, pothuaj aq i gjërë sa dhe i gjatë, "katror qysh në bazë", siç thotë një njeri i madh, turma e njohu menjëherë nga veshja e tij gjysmë e kuqe e gjysmë bojë vjollcë, e mbuluar me zilka argjendi, dhe sidomos nga shëmtimi i tij i pakrahasueshëm. Të gjithë thirrën me një gojë:

- Është Kuazimodoja, kambanari! Është Kuazimodoja i katedrales së Shën Mërisë! Kuazimodoja me një sy! Kuazimodo këmbështrembri! Rroftë! Rroftë!

Dukej sheshit se atij yqyari i kishin ngjitur gjithfarë nofkash.

- O majmun shëmtaraq!- thoshte njëra.
- Sa i lig, aq edhe i shëmtuar,- mbante ison një tjetër.
- Ky është i paudhi, vetë dora,- shtonte një e tretë.
- O shëmtirë e dreqit!
- O shpirt i mallkuar!
- Ptu!

Burrat, përkundrazi, ishin magjepsur e po brohorisnin.

Kuazimodoja, i zyrtë e hijerëndë, kishte qëndruar te pragu i kishëzës, ku njerëzit mund ta soditnin lirisht.

Usta Kopenoli, i mrekulluar, iu afrua dhe i tha:

- Për nder s'kam parë kurrë në jetën time një shëmtim kaq të përsosur! Ti meriton të jesh papë jo vetëm në Paris, por edhe në Romë.

Dhe, duke folur kështu, i rrahu supin gjithë gëzim. Kuazimodoja nuk luajti vendit. Kopenoli vazhdoi:

- Qerrata që je! Mua do të më pëlqente të bëja aheng me ty, edhe sikur të më kushtonte dhjetë lira të reja, Turi. Eh, ç'thua?

27. Sfondi ku zhvillohet kjo shfaqje është Katedralja e Parisit. Simbolika e këtij sfondi lidhet me: **1 pikë**

- A) idenë për turmën (agresive në dukje; e butë dhe e logjikshme në thelb);
- B) imazhin e Mesjetës (e bukur në dukje; e errët në thelb);
- C) mendimin për heroin (i fortë, i qëndrueshëm dhe i madhërishëm në dukje dhe në thelb);
- D) pozicionimin ndaj raportit të njeriut me mjedisin (në të gjitha kohërat).

28. Fragmenti i mësipërm, nga pikëpamja e subjektit, lidhet me momentet kur: **1 pikë**

- A) Esmeralda sapo i kishte shpëtuar grabitjes së Kuazimodos;
- B) Gijom Rimi po ndiqte me sy dështimin e shfaqjes së vet;
- C) Kuazimodo sapo ka shpëtuar nga përbuzja e turmës;
- D) Prifti Frolo i ka shprehur ndjenjat e tij Esmeraldës.



29. Cila prej fjalive të mëposhtme realizon kontrastin romantik fizik-shpirtëror, tipik për penën e Hygoit? **1 pikë**
- A) Kuazimodoja, i zyrtë e hijerëndë, kishte qëndruar te pragu i kishëzës, ku njerëzit mund ta soditnin lirisht.  
 B) Kur u duk ky lloj ciklopi te pragu i kishëzës, i palëvizur, me trup shulak, pothuaj aq i gjërë sa dhe i gjatë, “katror qysh në bazë”, siç thotë një njeri i madh, turma e njohu menjëherë nga veshja e tij gjysmë e kuqe e gjysmë bojë vjollcë, e mbuluar me zilka argjendi, dhe sidomos nga shëmtimi i tij i pakrahasueshëm.  
 C) Por, megjithë këtë shëmtim, tërë figura e tij shprehte një forcë, zhdërvjelltësi dhe guxim të hatashëm, - përjashtim i çuditshëm nga ajo rregull e përgjithshme, sipas së cilës forca, sikundër bukuria, duhet të burojë nga harmonia.  
 D) Por vetëm atëherë mahnitja dhe admirimi i popullit arritën kulmin; ngërdheshja ishte fytyra e tij e vërtetë ose, më mirë të themi, e tërë pamja e tij ishte një ngërdheshje.
30. Cila nga fjalitë e mëposhtme ndërtohet mbi një figurë stilistike të sintaksës? **1 pikë**
- A) Mua do të më pëlqente të bëja aheng me ty, edhe sikur të më kushtonte dhjetë lira të reja. Eh, ç’thua?  
 B) - O shëmtirë e dreqit! O shpirt i mallkuar! Ptu!  
 C) Ti meriton të jesh papë jo vetëm në Paris, por edhe në Romë.  
 D) Turma u sul te kisha dhe nxori së andejmi plot bujë papën e nderuar të gaztorëve.
- 31.
- a) Zbuloni në tekst fjalinë që karakterizon më mirë veprimet e turmës, shtyrë nga instinket. **1 pikë**
- 
- b) Duke i parë fjalitë e mëposhtme në kuadër të të gjithë fragmentit, zbuloni se çfarë e shkakton reagimin e Kuazimodos. **1 pikë**
- Dhe, duke folur kështu, i rrahu supin gjithë gëzim. Kuazimodoja nuk luajti vendit.*
- 
- c) Personazhet dialogues gati në të gjithë fragmentin jepen të paidentifikuar. Si mendoni ju, pse kjo zgjedhje e autorit? **1 pikë**
- 
- 32.
- a) Zbuloni një tipar të romantizmit të Hygoit në fragment. Mendimin tuaj ilustrojeni me një shembull. **2 pikë**
- 
- b) Në rreshtat e fundit shfaqen disa karakteristika të Kopenolit. Zbuloni një prej tyre, duke shpjeguar teknikën përmes së cilës realizohet karakterizimi i personazhit në këtë rast. **2 pikë**
- 
33. Analizoni një nga mjetet artistike përmes të cilit realizohet grotesku në fragment, duke u fokusuar tek imazhet që shpalosen në këtë përdorim. **2 pikë**
-

## PJESA III

## Ese

34. Nuk është gjithmonë e lehtë të marrësh anën e së drejtës, madje ndonjëherë është e rrezikshme.

Përshkruani një moment në jetën tuaj, kur ju e keni vendosur veten në rrezik (emocional, psikologjik apo fizik) për të bërë atë që mendonit se ishte e drejtë.

**8 pikë**

Në përgjigjen tuaj mbani parasysh:

- situatën dhe dilemën përballë vendimit që duhet të ndërmerrnit;
- gjendjen tuaj shpirtërore në një situatë të tillë.

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

Shtjellimi i idesë (34 a)	Organizimi dhe struktura (34 b)	Stili dhe origjinaliteti (34 c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (34 d)	Totali 34
2	2	2	2	8

*Shënim: Këto faqe mund të përdoren nga nxënësit për të bërë planifikimin e esesë, por nuk do të vlerësohen.*

